



Datë: 12.03.2026
Numër Protokolli: 1302/2026

A.nr.1939/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1939/2025, të datës 25.11.2025, të parashtruar nga ankuesi A.B, kundër organit të punësimit: Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1939/2025, e datës 25.11.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.B.

A r s y e t i m

Ankuesi, A.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 25.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër anulimit të konkurseve të vitit 2024 dhe 2025 nga Ministria e Mbrojtjes. Rrjedhimisht, ankuesi lidhur me vitin 2024, i referohet procedurave të rekrutimit, sipas konkursit me numër reference RN00015371, pozita Zyrtar për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar; konkursit me numër reference RN00015351, pozita Psikolog, konkursit me numër reference RN00015336, pozita Instruktor i gjuhës gjermane; konkursit me numër reference RN00015337, pozita Zyrtar Ligjor; konkursit me numër Reference RN00015338, pozita Zyrtar Ligjor; konkursit me numër Reference RN00015339, pozita Zyrtar Ligjor, konkursit me numër Reference RN00015325, pozita Shef i Sektorit për Bashkëpunimin Civil-Ushtarak, konkursit me numër Reference RN00015117, pozita Zyrtar për Protokoll dhe konkursit me numër Reference RN00015068, pozita Zyrtar për Protokollin. Ndërsa, lidhur më vitin 2025 i referohet konkursit me numër reference RN00018670, për Zyrtar për Kodifikim të E-Qeverisjes; konkursit me numër reference RN00018671, për Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve; konkursit me numër reference RN00018683, për Shef i Njesisë së Protokollit; konkursit me numër reference RN00018484, për Zyrtar për Programe; konkursit me numër reference RN00018476, për Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun; konkursit me numër reference RN00018492, për Zyrtar për Bashkëpunim Bilateral dhe konkursit me numër reference RN00018499, për Udhëheqës për Integritet Euroatlantike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi **është e palejuar**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të çështjes rrjedhë se Ministria e Mbrojtjes në vitin 2024 kishte shpallur konkurset: Nr. Ref: RN00015371 ,për pozitën Zyrtar për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar, i shpallur me datë 04.10.2024; Nr. Ref: RN00015351, për pozitën Psikolog, i shpallur me datë 04.10.2024; Nr.Ref: RN00015336, për pozitën Instruktor i gjuhës gjermane, i shpallur me datë 02.10.2024; Nr. Ref: RN00015337, për pozitën Zyrtar Ligjor i shpallur me datë 02.10.2024; Nr.ref:RN00015338, për pozitën Zyrtar Ligjor, i shpallur me datë 02.10.2024; Nr. Ref: RN00015339, për pozitën Zyrtar Ligjor, i shpallur me datë 02.10.2024; Nr.Ref: RN00015325 për pozitën Shef i Sektorit për Bashkëpunimin, i shpallur me datë 01.10.2024; Nr. Ref. RN00015117 për pozitën Zyrtar për Protokoll, i shpallur me datë 12.09.2024 dhe Nr.Ref:RN00015068 për pozitën Zyrtar për Protokolli, i shpallur me datë 09.09.2024, mirëpo, Drejtoria e Burimeve Njerëzore përmes Njoftimit të publikuar në SIMBNJ më datë 08.10.2024, ka anuluar këto konkurse me arsyetimin se Ministria e Mbrojtjes dhe personeli civil në Forcën e Sigurisë së Kosovës është në procesin e ristrukturimit i cili pritet për përfundoj shpejtë.

Tutje, sipas shkresave të lëndës del se Ministria e Mbrojtjes më datë 25.08.2025, ka shpallë konkurset: RN00018484 për pozitën Zyrtar për Programe; nr.ref: RN00018476, për pozitën Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun RN00018492, për Zyrtar për Bashkëpunim Bilatera: RN00018499, për pozitën Udhëheqës për Integritet Euroatlantike, ndërsa, më datë 16.09.2025, janë shpallur konkurset: RN00018670, për pozitën Zyrtar për Kodifikim të E-Qeverisjes; RN00018671, për pozitën Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve; RN00018683, për pozitën Shef i Njësisë së Protokollit. Kurse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, më datë 07.11.2025, ka publikuar Vendimin me numër reference Ref.DBN-MM-956/2025, për anulimin e këtyre procedurave më arsyetimin se anulimi behët mbi bazën e kërkesës së Zëvendës ministrit të MM-së të datës 31.10.2025, përmes së cilës ishte kërkuar: ” *Meqenëse MM është në proces të ristrukturimit dhe një gjë e tillë është prioritet mbi prioritetet posa të formohet qeveria e re, kërkoj që të gjitha pozitat që janë në proces të rekrutimit të anulohen deri në një vlerësim të ri mbi nevojat e strukturës së re të MM-së*”.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranushmërinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 27 paragrafi 3 dhe 4 dhe nenit 39 paragrafi 12, ku përcaktohet: “ **Neni 27..3.** *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.* **4.** *E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo candidateje/i në procedurë pranimit në shërbimin civil*”, .. **Neni 39: 12.** *Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankesë në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.*

Rrjedhimisht, në kuptim të së drejtës në mjete juridike, si një nga të drejta themelore të garantuara në procedurë administrative, Kolegji ju referua edhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me theks të veçantë: -**Neni 14: 1.** *Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e*

interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.- **Nenit 124 paragrafi 1:** *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë.-* **Nenit 125:** *1.Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”); 2. Një veprim procedural i një organi publik gjatë procedurës administrative, mund të ankimohet ndaras, vetëm kur kjo parashihet shprehimisht me ligj. 3. Një veprim procedural, i paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, do të jetë cilido akt, veprim apo mosveprim i organit publik gjatë procedurës administrative, që nuk është një akt administrativ përfundimtar apo akti administrativ i përfundimit të procedurës administrative, siç është paraparë me nenin 97 të këtij Ligji. -* **Neni 127:** *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrrojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit. 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ. -* **Nenit 129** *1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.”,*

Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor si më sipër, Kolegji konstaton së ankesa e ankuesit kundër anulimit të konkurseve të vitit 2024 (RN00015371, RN000015351, RN00015351, RN00015337, RN00015338, RN00015339, RN00015325, RN00015117 dhe RN00015068), është e parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse, njoftimi për anulim të konkurseve është shpall në SIMBNJ më datë 08.10.2024, ndërsa, ankuesi ushtron ankesë në Këshill më datë 25.11.2025, pra, pas një (1) viti. Kështu që, duke qenë së ankuesi nuk ka respektuar afatin ligjor për parashtrim të ankesës, atëherë, ankesa e ankuesit ndaj anulimit të konkurseve të vitit 2024, është e palejuar në kuptim të nenit 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa, lidhur më anulimin e konkurseve të vitit 2025 (RN00018670, RN00018671, RN00018683, RN00018484, RN00018476, RN00018492, RN00018499), Kolegji duke ju referuar konfirmimit të datës 10.12.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mbrojtjes, konstaton së pala ankuese nuk ka aplikuar në asnjërin nga konkurset e kontestuar, rrjedhimisht, ankuesi nuk ka qenë kandidat në këto procedura të pranimit, andaj, edhe mbi këtë fakt, Kolegji erdhi në përfundimin së ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse, më Vendimin për anulim të konkurseve të datës 07.11.2025, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë e aplikimit, kështu që, ankuesit i mungon legjitimiteti i palës në procedurë, andaj, edhe ankesa e ankuesit kundër anulimit të konkurseve të vitit 2025 është e palejuar në kuptim të nenit 39, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur

me nenin 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1939/2025

Avdyl Bekteshi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, A.B;
- Udhëheqësit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Arkivit të KPMSHCK-së.